



NJOFTIM INSTITUCIONEVE

Për rezultatet e projektit “Pozita zyrtare e gjuhës shqipe në Malin e Zi”

1. Përshkrimi i projektit

Këshilli Kombëtar i Shqiptarëve në Malin e Zi vazhdimisht i ka kushtuar vëmendje në punën e tij, pozitës dhe statusit të gjuhës shqipe, duke konsideruar se gjuha shqipe dhe kultura e shqiptarëve në Malin e Zi janë bazë kryesore e identitetit kombëtar të tyre. Prandaj e ka parë shumë të rëndësishme që në nivel profesional dhe shkencor të realizojë projektin “**Pozita zyrtare e gjuhës shqipe në Malin e Zi**”, të cilën e ka udhëhequr dr. Haxhi Shabani, i cili edhe në punën e tij individuale shkencore është marrë me këtë çështje si në temën e magjistraturës për “Dygyhësinë në qytetin e Ulqinit” të doktoratës për “Dygyhësinë e Shqiptarëve në Malin e Zi”, duke botuar edhe librin “Rrezikimi i gjuhës shqipe”, 2007.


Vëzhgimi i përdorimit, i pozitës, i statusit, i situatave të ndryshme gjuhësore të shqipes në Malin e Zi, përkatësisht i përdorimeve të saj publike e zyrtare ka qenë i vazhdueshëm gjatë tërë realizimit të projektit, një kujdes i veçantë i është kushtuar punës në terren e cila është realizuar gjatë periudhës 15 maj 2022 - 25 qershor 2022.

Janë hulumtuar situatat e ndryshme gjuhësore në strukturat e ndryshme të qeverisjes vendore (lokale) në komunat: Ulqin, Tuz, Guci, Plavë, Tivar e Rozhajë. Po ashtu hulumtimi ka përfshirë edhe nga një shkollë fillore dhe të mesme ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhën shqipe në komunat: Ulqin, Tuz, Plavë dhe në shkollat fillore në Ostros (komuna e Tivarit) dhe në Dacaj (komuna e Rozhajës), pasi në këto dy komuna nuk ka shkolla të mesme në të cilat mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe. Janë përdorur metoda, teknika e strategji të cilat janë konsideruar më të përshtatshme për realizimin e këtij projekti (studimi) si: hulumtimi i situatave gjuhësore në dokumentet zyrtare në institucionet e qeverisjeve vendore, të shkollave dhe mbishkrimeve publike, pastaj janë anketuar zyrtarët në këto institucione, është realizuar intervistimi me nëpunës të zgjedhur, është bërë vëzhgimi i mbishkrimeve publike dhe faqeve zyrtare elektronike të komunave përkatëse.




2. Paraqitja grafike e rezultateve të dokumenteve nëpër komuna

1. DOKUMENTET ZYRTARE NË KOMUNËN E ULQINIT



Në komunën e Ulqinit dokumentet vetëm në gjuhën malazeze janë: 62.20%, kurse në dy gjuhë: gjuhë malazeze- gjuhë shqipe janë 28.80% e tyre dhe vetëm në gjuhën shqipe janë 9% e dokumenteve.


2. DOKUMENTET ZYRTARE NË KOMUNËN E TUZIT





Në komunën e Tuzit më së shumti janë në përdorim dokumentet të shkruara në dy gjuhë: gjuhë malazeze-gjuhë shqipe në masën 52.50%, pastaj vijnë ato që janë vetëm në gjuhën malazeze-27.50 %, kurse nga 10% ka dokumente vetëm në gjuhë shqipe, aq sa ka edhe në gjuhë shqipe-gjuhë malazeze.


3. DOKUMENTET ZYRTARE NË KOMUNËN E GUCISË



Në komunën e Gucisë 62.85% nga dokumentet të cilat janë marrë si mostër, janë të shkruara vetëm, pastaj janë 25.71% në të cilat përdoret gjuha malazeze dhe gjuha shqipe, kurse në 11.44 % përdoret vetëm gjuha shqipe.




4. DOKUMENTET NË KOMUNËN E PLAVËS



Nga dokumentet që janë marrë në shqyrtim në komunën e Plavës: 66.70%-janë të shkruara vetëm në gjuhën malazeze, kurse në 30% të tyre respektohet dygjuhësia: gjuhë malazeze-gjuhë shqipe, ndërkaq situatat e tjera gjuhësore dalin në një përqindje tejet të vogël.

5. DOKUMENTET NË TË GJITHA KOMUNAT





Duke marrë parasysh të gjitha dokumentet në nivel të komunave të cilat janë marrë për bazë, vërehet se numri më i madh i dokumenteve në gjuhën malazeze është në komunën e Ulqinit-18. 66%, kurse më i vogël në komunën e Tuzit, 7.33%. Ndërkaq, në komunën e Tuzit është në përdorim numri më i lartë i dokumenteve në dy gjuhë: gjuhë malazeze-gjuhë shqipe, pastaj vjen komuna e Ulqinit me 8.66% e Gucisë dhe Plavës. Duke krahasuar dy komunat në të cilat shqiptarët janë shumicë: shqipja në institucionet publike të tyre përdoret më shumë në komunën e Tuzit sesa në atë Ulqinit. Vlen të theksohet se komuna e Ulqinit dhe e Tuzit kanë një numër të njëjtë të dokumenteve të cilat janë vetëm në gjuhën shqipe, nga 6%.

3. Përfundimet kryesore të projektit “Pozita zyrtare e gjuhës shqipe në Malin e Zi”

Pas hulumtimit të përdorimit me shkrim dhe me gojë të gjuhës shqipe në Malin e Zi në nivelet e ndryshme institucionale, përkatësisht të përdorimit të saj publik në kuadër të projektit studimor “Pozita zyrtare e gjuhës shqipe në Malin e Zi” janë arritur këto rezultate kryesore:

1. Gjuha shqipe në Malin e Zi nuk është gjuhë e parë në të cilën fillimisht hartohen dokumentet zyrtare jo vetëm në nivelin e institucioneve qendrore, apo të themeluara nga niveli qendror, por as gjuhë bazë (e parë) e dokumenteve zyrtare që përdoren në qeverisjet vendore (lokale), në të cilat shqiptarët janë shumicë dërmuese, apo një pjesë e konsiderueshme, duke përfshirë edhe komunën e Ulqinit dhe të Tuzit.

2. Gjuha malazeze është gjuha bazë (e parë) të cilën e përdorin shqiptarët në Malin e Zi për të hartuar dokumentet zyrtare në strukturat e qeverisjes vendore (lokale) ashtu edhe qendrore si në: komuna, ndërmarrje publike vendore dhe qendrore, shkolla, gjykata, në sistemin bankar, tregti, turizëm, bujqësi e degë të tjera të ekonomisë dhe fushat e tjera. Gjuha shqipe në Malin e Zi në dokumentet zyrtare është gjuhë e përkthyer dhe zakonisht del e dyta, krahas gjuhës malazeze. Pothuajse rregullisht ndodh që fillimisht dokumenti zyrtar hartohet nga shqiptarët në gjuhën malazeze dhe pastaj përkthehet në gjuhën shqipe. Kjo dukuri, siç është pohuar edhe në përfundimin e parë, e klasifikon gjuhën shqipe në dokumentet zyrtare si një gjuhë jo origjinale, por të përkthyer, edhe në situatën kur subjektet që e përdorin atë në këtë pozicion janë shqiptarë.



3. Në institucionet lokale dhe qendrore që gjenden në komunën e Ulqinit dhe Tuzit në të cilat shqiptarët janë shumicë, por edhe në komunën e Gucisë, ku janë pjesë e konsiderueshme si dhe në komunën e Tivarit, Plavës e Rozhajës, në të cilat shqiptarët janë mbi 5%, në situatat (domenet) ku nuk përdoret gjuha shqipe në formë zyrtare, përkatësisht publike me shkrim dhe me gojë bëhet shkelja e dokumentit ndërkombëtar evropian siç është Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale dhe të Pakicave, pastaj e Kushtetutës së Malit të Zi, Ligjit për të Drejtat dhe Liritë e Pakicave dhe e statuteve të komunave përkatëse. Por deri më tash nuk ka ndodhur që ndonjë institucion publik apo privat të dënohet për moszbatimin e përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe në Malin e Zi, pasi kjo nuk parashikohet me ndonjë masë ligjore. (Mali i Zi nuk ka ligj të posaçëm për përdorimin e gjuhëve).

4. Përdorimi i dygjuhësisë është i përhapur, por jo gjithëpërfshirës në komunat në të cilat shqiptarët janë shumicë si në: Ulqin Tuz e në Guci. Gjuha shqipe përdoret në këto komuna në dokumentet zyrtare, në mbishkrime e emërtime të ndryshme publike duke dal si gjuhë e dytë, krahas gjuhës malazeze. Rrallë ndodh që ajo të përdoret përpara gjuhës malazeze.

5. Gjuha shqipe është gjuhë e përjashtuar në komunikimin zyrtar me shkrim dhe me gojë në nivel të institucioneve lokale dhe qendrore si në dokumente zyrtare, mbishkrime dhe emërtime të ndryshme publike në komunën e Tivarit, Plavës dhe Rozhajës. Përjashtim bëjnë disa mbishkrime në komunën e Plavës të cilat janë të shkruara edhe në gjuhën shqipe, por shqipja në kuadër të dokumenteve zyrtare është e pa përfshirë. Në komunën e Tivarit dhe Rozhajës gjuha shqipe ka përdorim shumë të kufizuar publik vetëm në radiot lokale në këto dy komuna, në të cilat ka program shumë të kufizuar në gjuhën shqipe, si dhe në disa situata në institucionet fetare. Përgjithësisht, me ndonjë përjashtim të rrallë gjuha shqipe nuk përdoret në variantin e shkruar gjatë komunikimit zyrtar në fusha të ndryshme të jetës publike të cilat janë të kontrolluara nga niveli i qeverisjes e pushtetit qendror si në politikë, ekonomi, sistemin gjyqësor, bankar etj.

6. Në faqet zyrtare të internetit të komunave: Ulqin, Tivar e Guci ekziston edhe faqja në gjuhën shqipe. Aty janë të paraqitura dokumente të ndryshme në shqip, por ndodh që në këto faqe, megjithëse dokumenti titullin e ka në gjuhën shqipe, përmbajtja jepet në gjuhën malazeze.



7. Gjuha shqipe përdoret si e vetme, apo krahas gjuhës malazeze në disa dokumente kryesore zyrtare në shkolla për nxënësit që mësimin e ndjekin në gjuhën shqipe si në: ditar, dëftesa, librin e amzës, pastaj gjatë plotësimit të orëve, në procesverbale nga mbledhja e prindërve. Por në disa nga dokumentet e tjera shkollore si në programin vjetor, në procesverbalet nga mbledhjet e këshillit të arsimtarëve, në komunikimin që shkollat bëjnë me pushtetin qendror e vendor (lokal), bëhet përdorimi i gjuhës malazeze, me përjashtime të rralla kur përdoret edhe gjuha shqipe, si në rrjetet zyrtare sociale apo faqet në internet të shkollave, ku del edhe gjuha shqipe si pjesë përbërëse e komunikimit, zakonisht si gjuhë e dytë.

8. Në shkollën fillore dhe të mesme nuk janë të përfshirë të gjithë nxënësit shqiptarë në Malin e Zi, sidomos në komunën e Tivarit dhe Rozhajës, në të cilat përveç se në vendbanimet rurale ku ka shkolla fillore në shqip, në komunën e Tivarit, në Krajë, kurse në komunën e Rozhajës, në Dacaj, në qytetet përkatëse jo vetëm që nuk ka asnjë shkollë në të cilën mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe, por gjuha shqipe nuk mësohet as si lëndë me mundësi zgjedhjeje. Përgjithësisht në të gjitha komunat ku jetojnë shqiptarët në Malin e Zi, në shkollën fillore dhe të mesme ekziston një numër i konsiderueshëm i nxënësve shqiptarë të cilët mësimin e vijojnë në gjuhën malazeze.

Sa i përket shkollimit të lartë një numër i konsiderueshëm i të rinjve shqiptarë në Malin e Zi shkollimin e tyre e përfundojnë në gjuhën jo (amtare shqipe), shumica në gjuhën malazeze, por ka të atillë që këtë nivel të shkollimit e kryejnë në gjuhë të huaja. (Në Malin e Zi në gjuhën shqipe ekziston vetëm Programi Studimor për Mësuesit në Gjuhën Shqipe, në kuadër të Universitetit të Malit të Zi).

9. Në komunat në të cilat jetojnë shqiptarët në Malin e Zi dominojnë mbishkrimet publike në gjuhën malazez. Në komunën e Ulqinit, Tuzit e në njëfarë mase edhe në atë të Gucisë në mbishkrimet publike dhe emrat e vendeve shqipja del krahas gjuhës malazeze dhe bëhet përdorimi i shumëgjuhësisë, kurse në ndonjë rast në zonat rurale, mund të gjendet ndonjë emër vendi i shkruar vetëm në gjuhën shqipe.



10. Shumica e veprimtarive kulturore, artistike, letrare, promovuese e shqiptarëve në Malin e Zi bëhet në gjuhën shqipe, sidomos në qytetin e Ulqinit, Tuzit, në Anë të Malit e Krajë. Veprimtari të rralla në gjuhën shqipe në fushë të kulturës ka edhe në Guci, Plavë e Rozhajë. Në komunat ku jetojnë shqiptarët organizohen edhe veprimtari kulturore dygjuhësore, në të cilat shqipja si gjuhë komunikimi herë përdoret e para, herë e dyta. Përdorimi i shqipes bëhet edhe në fushë të botimeve, por ka edhe botime dygjuhësore shqip dhe në gjuhën malazeze.

11. Disa nga arsyet kryesore se pse gjuha shqipe, me përjashtime të rralla nuk përdoret si gjuhë në të cilën hartohen dokumentet zyrtare janë: nuk ka gatishmëri të organeve lokale e qendrore për t'u marrë seriozisht me këtë çështje, mungojnë strukturat e nevojshme kadrovike dhe teknike zyrave të përkthimit brenda institucioneve, mungon tradita përkatëse për të hartuar dokumentet zyrtare në gjuhën shqipe dhe shqiptarët nuk janë vetëdijshëm sesa është e rëndësishme që gjuha shqipe të jetë gjuhë e përfshirë në nivelin zyrtar e publik, edhe pse këto përdorime janë të përcaktuara me kushtetutë dhe dispozita ligjore.

4. Rekomandime për përmirësimin e pozitës dhe statusit zyrtar e publik të gjuhës shqipe në Malin e Zi

1. Duhet të merren masa konkrete që shqiptarët në Malin e Zi, të vetëdijesohen për pozitën dhe statusin real të gjuhës shqipe, sidomos për përdorimin zyrtar e publik të saj, pasi që: së pari, gjuha e tyre amtare, shqipja, në vendet ku jetojnë ata në Malin e Zi në formë të shkruar e gojore ka përdorim tejet të kufizuar sidomos në administratën publike dhe së dyti: gjuha shqipe, përveç se në Ulqin e Tuz, është gjuhë me përdorim shumë të reduktuar zyrtar-në Guci e Plavë, kurse në Tivar e Rozhajë-në përdorimin publik, është e përjashtuar.

Duhet të hartohen e realizohen fushata e projekte me përfshirje të gjerë, në mënyrë që shqiptarët në Malin e Zi të binden se përpjekjet për përdorimin e gjuhës shqipe, sidomos në situatat publike janë të drejta të tyre kushtetuese e ligjore të pranuar nga Mali i Zi zyrtar si dhe në nivel ndërkombëtar, që duhet të zbatohen në praktikë, sepse gjuha është thesari i tyre më i rëndësishëm kulturor e shpirtëror, përkatësisht tipari i tyre themelor kombëtar.



2. Komunitet në të cilat jetojnë shqiptarët në Malin e Zi, sidomos komuna e Ulqinit, e Tuzit dhe Gucisë, por edhe Tivarit, Plavës dhe Rozhajës, po ashtu në kudër të Parlamentit të Malit të Zi në një fazë të parë, duhet të themelohen (ngrihen) njësi organizative (zyrat e përkthimit me staf të përgatitur dhe pajisjet adekuate që të realizojnë përdorimin praktik zyrtar e publik të gjuhës shqipe në të gjitha dokumentet e situatat e përdorimit në institucionet publike lokale edhe në ato qendrore dhe private, duke hartuar plane të hollësishme për përdorimin e gjuhës shqipe, zbatimin e këtij procesi si dhe përcjelljen e zbatimit të tij nga grupe ekspertesh të pavarur të fushës, duke krijuar edhe mekanizma të sanksioneve për moszbatimin në praktikë. Në kuadër të këtij projekti, fillimisht të hartohet një udhëzues në formë doracaku i cili përcakton konkretisht përdorimet e gjuhës shqipe në situata të ndryshme bazuar në dokumentet ndërkombëtare përkatëse në Kushtetutën e Malit të Zi si dhe ligjet në fuqi.

3. Të krijohen struktura për mbrojtjen dhe studimin e gjuhës shqipe në Malin e Zi. Fillimisht komuna e Ulqinit, e Tuzit dhe e Gucisë të krijojnë fonde të përhershme vjetore për gjuhën shqipe dhe kulturën shqiptare në Malin e Zi, sikurse edhe Qeveria e Malit të Zi, si dhe të kërkohen fonde të këtilla edhe nga dy shtetet shqiptare Shqipëria e Kosova dhe diaspora shqiptare të cilat do të bëhen të rregullta dhe të përhershme. Të krijohen forma bashkëpunimi me institucionet arsimore, kulturore, universitare, artistike të cilët do të ndikonin në ruajtjen dhe studimin e gjuhës shqipe në Malin e Zi, si dhe në mbrojtjen e zhvillimin e identitetit kombëtar e kulturor të tyre. Kurse më pastaj, të formohet Instituti për Mbrojtjen dhe Studimin e Gjuhës Shqipe dhe Kulturës Shqiptare në Malin e Zi i cili do të kishte të ardhura vjetore nga buxheti i qeverisë vendore.